



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:073937

Datë: 05.10.2023

Numri i dokumentit: 04759038

PPP.nr.588/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Blerand Rrmoku, në çështjen juridike përmbarimore ndërmjet kreditores F.S nga P, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson A.H, avokat në G, kundër debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës - SHSKUK, me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarimore përmbushje e borxhit, vlera 1209.00€, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.298/20, të datës 11.03.2020, të lejuar nga Përmbaruesi Privat H.H në G, jashtë seancës gjyqësore, me datë 05.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I.** REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës - SHSKUK, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhërit për lejimin e përmbarimit P.nr.298/20, të datës 11.03.2020, të lejuar nga Përmbaruesi Privat H.H në G.
- II.** DETYROHET debitori Qendra Klinike Universitare e Kosovës - SHSKUK, me seli në Prishtinë, që kreditores F.S nga P, në emër të përgjigjes në prapësim t'ia paguajë shumën prej 104.00 €.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat H.H në G, duke vepruar sipas propozimit të kreditores F.S, ka lëshuar Urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës 01Nr.21-542/212, të datës 27.02.2020, me të cilin debitori është obliguar që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të Urdhërit, t'ia paguajë kreditores shumën prej 1,131.00€, në emër të kompensimit për tre paga jubilarë, si dhe shumën prej 78.00 Euro për përpilimin e ankesës pranë Inspektoratit të Punës, në shumë të përgjithshme prej 1209.00 Euro si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim. Në prapësim ndër tjera pretendohet se propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me nenet 24 par. 3 dhe 5, 36 par. 1, 37 dhe 38 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, pasi propozimit

për përmbardim është paraqitur pa kaluar afati paritiv për përmbardhjen e detyrimit. Tutje pretendohet se në bazë të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative, akti administrativ ekzekutohet kur hyn në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vetë organi administrativ i cili e ka nxjerrë aktin, ndërsa në rastin konkret vendimi në fjalë nuk është bërë i ekzekutueshëm sepse sipas këshillës juridike pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, të cilën të drejtë debitori e ka shfrytëzuar. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që urdhri përmbardimor të ndryshohet dhe propozimi për përmbardim të hedhet poshtë si i pa bazë.

Kreditorja ka ushtruar përgjigje në prapësim përmes përfaqësuesit të autorizuar, në të cilën ka theksuar se organi përmbardues urdhrin për përmbardim e ka nxjerrë në kuptim të nenit 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, dhe si i tillë i ka plotësuar të gjitha kushtet sipas nenit 24 par 3 të LPP-së. Tutje pretendohet se nuk qëndron pretendimi i debitorit që dokumenti përmbardimor i nxjerrë në procedurë administrative nuk i ka tiparet e përmbardueshmërisë, duke iu referuar dispozitës së nenit 36 të LPP-së, pasi në rastin konkret vendimi i tillë është i përmbardueshëm sipas nenit 24 par.5 të LPP-së, si dhe nenit 6.4 të Ligjit për Inspektoratin e Punës. Po ashtu theksohet se prapësimi nuk është i bazuar në ligj dhe në kundërshtim me nenin 69 par.5 të LPP-së, ku është paraparë se ankesa apo mjetit tjetër juridik nuk e ndalon ekzekutimin e Vendimit të nxjerr nga Inspektorati i Punës, debitori ka qenë i obliguar që të njëjtin ta ekzekutojë brenda 8 ditësh, duke pretenduar se Urdhëri përmbardimor është lëshuar në bazë të dokumentit përmbardimor - vendimit të nxjerrë në procedurë administrative që ka të bëjë me një detyrim në kuptim të nenit 22 par 1 nën par 1.2 të LPP-së. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhëri përmbardimor.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të përfaqësuesit të autorizuar të kreditorës të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i pa bazuar për arsyt në vijim:

Dispozita nga neni 22 par.1 e LPP-së, e cila përcakton llojet e dokumenteve përmbarduese, në nënpar 1.2 parasheh që: *“Dokumente përmbarduese janë: vendimi përmbardues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)”*. Tutje, dispozita nga neni 24 par.3 e LPP-së parasheh që: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbardimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t'i përmbajë një dokument përmbardimor në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përmbardim. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përmbardimor është i përshtatshëm për përmbardim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumën dhe kohën e përmbardhjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, në mënyrë që dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbardimi t'i njihet cilësia e dokumentit të përshtatshëm për përmbardim.

Në rastin konkret, përmbardimi është lejuar në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës 01Nr.21-542/212, të datës 27.02.2020. Nga vlerësimi i këtij dokumenti, Gjykata gjen se i njëjti paraqet vendim të dhënë në procedurë administrative, si dhe përmban të dhëna për kreditorin, debitorin, objektin, mjetet, shumën dhe kohën e përmbardhjes së detyrimit dhe si i tillë i përmbardhë të gjitha kriteret ligjore të përcaktuara nga nenet 22, 24 dhe 27 të LPP-së për tu konsideruar i përshtatshëm për përmbardim, në kuptim të dispozitës nga neni 21 të LPP-së, e cila parasheh që: *“Organi përmbardues*

e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”.

Gjykata me rastin e vendosjes trajtoi pretendimet e ngritura nga ana e debitorit lidhur me faktin se në bazë të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative, akti administrativ ekzekutohet kur hyn në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vetë organi administrativ i cili e ka nxjerrë aktin, ndërsa në rastin konkret vendimi në fjalë nuk është bërë i ekzekutueshëm sepse sipas këshillës juridike pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, të cilën të drejtë debitori e ka shfrytëzuar.

Lidhur me këto pretendime, Gjykata iu referua Ligjit për Inspektoratin e Punës, përkatësisht dispozitës së nenit 6 par.4 të të njejtit, ku përcaktohet: “Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit”. Në kontekst të njejtë, dispozita nga neni 24 par.5 e LPP-së parasheh që: “Përmbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarimin”. Në bazë të interpretimit të këtyre dispozitave, Gjykata vlerëson se fakti që palët kanë pasur të drejtën e ankesës ndaj vendimit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, nuk paraqet kurrfarë pengese për caktimin e përmbarimit duke iu referuar vendimit në fjalë, pasi dispozitat e lartëcekura janë të karakterit përjashtues dhe si të tilla ua japin cilësinë e dokumentit përmbarues edhe vendimeve të cilat nuk e kanë formën e prerë apo që nuk janë bërë përfundimtare, siç ka ndodhur në rastin konkret. Bazuar në një vlerësim të tillë, Gjykata pretendimet e parashtrura nga ana e debitorit i vlerëson si të pa bazuara dhe rrjedhimisht pa ndikim në një vendosje ndryshe e cila do të rezultonte me aprovimin e prapësimit dhe anulimin e Urdhërit Përmbarimor. Mbi këtë bazë, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi Urdhërin Përmbarimor të goditur me prapësim.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e mbështeti në dispozitat nga nenet 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 paragrafi 4 të LPP-së, duke e obliguar debitorin që kreditores Nexhmije Spahija nga Prishtina, në emër të përgjigjes në prapësim t’ia paguajë shumën prej 104.00 €, konform Tarifës së Odës së Avokatëve

Mbi bazën e arsyeve të lartëcekura, në kuptim të dispozitës nga neni 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.588/21, datë 05.10.2023

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.